



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë/Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i
Tergovine /Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

Ref.02/Nr. 349
Datë: 30.12.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bazuar në nenin 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr. 7/01 Mars 2019), nenin 25 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare nr. 19, datë 21.07.2022), udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, merr:

V E N D I M

Miratohet Përditësimi i Planit të Integritetit i hartuar nga Grupi Punues, i caktuar me Vendimin Nr.5416 datë 02.12.2025.

A R S Y E T I M

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, në raport me detyrimet e Administratës Qendrore dhe Agjencitë e Pavarura.

Në kuadër të kësaj, sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka miratuar Vendimin Nr.5416 datë 02.12.2025.

Znj. Kosovare Kelmendi në pozitën Zv.Udhëheqëse e Divizionit të Inovacionit, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, e cila monitoron procesin sipas Planit të Integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga Institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ajo çfarë u theksua më sipër, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.


Agim Xhuraç
U.d. i Sekretarit të Përgjithshëm

Vendimi i dërgohet:

- *Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;*
- *Anëtareve të Grupit Punues;*
- *Personit Përgjegjës;*
- *Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;*
- *Arkivit.*



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

**Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i
Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade**

PËRDITSIMI I PLANI PËR INTEGRITET

2024-2026

PËRMBAJTJA

Deklarata e Integritetit	
Lista e shkurtimeve	
Hyrja	
Koncepti, qëllimi dhe objektivat i planit të integritetit.....	
Plani i Integritetit	
Qëllimi i planit të integritetit	
Objektivat	
Përmirësimi i etikës dhe mekanizmave të integritetit në ministri	
Menaxhimi i burimeve njerëzore	
Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare	
Menaxhimi i buxhetit dhe kontrollit financiar	
Prokurimit publik dhe menaxhimi i kontratave	
Metodologjia e planit të integritetit	
Procesi i zhvillimit të planit të integritetit	
Fushat e rrezikut	
Fushat e përgjithshme të rrezikut	
Metodologjia e vlerësimit të rrezikut	
Metoda e vlerësimit të rrezikut	
Monitorimit i zbatimit të planit të integritetit dhe raportimi	
Përditësimet	

Deklarata e Integritetit

Plani i Integritetit është dokument strategjik, që ka për qëllim vendosjen e veprimeve për sigurimin e integritetit në arritjen e objektivave të Ministrisë, të orientuara në ofrimin e shërbimeve efikase me përgjegjësi të lartë morale, të bazuara në transparencë dhe llogaridhënie përgjatë realizimit të proceseve vendimmarrëse të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT).

Plani i integritetit thekson përkushtimin e Ministrisë për të fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në ngritjen e standardeve profesionale dhe aplikimin e rregullave të zbatueshme normative, për parandalimin dhe shmangien e veprimeve të mundshme që cenojnë integritetin në arritjen e objektivave dhe qëllimeve tona, si parakusht për zhvillimin demokratik të institucioneve në kuptim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike.

Me planin e integritetit do të zbatohen në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse standardet e larta profesionale duke identifikuar rreziqet e mundshme, si dhe duke ndërmarrë masa për parandalimin e situatave që mund të cenojnë integritetin e institucionit. Përmes zbatimit të veprimeve të përcaktuara me planin e integritetit, rrjedhimisht do të forcohen vlerat etike dhe profesionale në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që mundësojnë zbatimin e legjislacionit për ngritjen e besimit të qytetarëve në institucionet publike.

MINT zotohet se gjatë fushëveprimtarisë së saj do të investojë në zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të Ministrisë, për të ofruar shërbimet efikase të bazuara në vlera profesionale, neutralitet, profesionalizëm, llogaridhënie, përgjegjësi dhe integritet.

Agim Xhuraj



U.d Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Industrisë,
Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Lista e shkurttimeve

MINT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

KM – Kabineti i Ministres

ZSP – Zyra e Sekretarit të Përgjithshme

DSHP – Departamenti për Shërbime të Përgjithshme

DBF – Departamenti për Buxhet dhe Financa

DIEKP – Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave

DL – Departamenti Ligjor

DI – Departamenti i Industrisë

DT – Departamenti i Turizmit

DMK – Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit

DRSHM – Departamenti për Rezervat Shtetërore të Mallrave

DKTMS – Departamenti i Kontrollit të Tregut të Mallrave Strategjike

DRRTN – Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës

DT – Departamenti i Tregtisë

DIS – Departamenti për Investime Strategjike

DN – Departamenti i Ndërmarrësisë

DI – Departamenti i Inovacionit

NJBNJ – Njësia e Burimeve Njerëzore

DP – Divizioni i Prokurimit

DKP – Divizioni për Komunikim Publik

DAB – Divizioni i Auditimit të Brendshëm

Hyrja

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/l-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit”, MINT obligohet të miratojë Përditësimin Planin e Integritetit, të paraparë për periudhën 2024 -2026. Në kuadër të këtij plani do të konsolidohet një sistem/mekanizëm për menaxhimin e integritetit në kuadër të MINT. Ministria përmes mekanizmave do të sigurojë transparencë, llogaridhënie dhe integritet. Për këtë arsye, grupi punues ka përditësuar planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit, i cili përfshin masat e kontrollit të brendshëm. Masat e përshkruara në këtë plan të integritetit do të zbatohen në zvogëlimin apo eliminimin e risqeve të integritetit, afatet kohore dhe përgjegjësitë organizative për zbatimin e tyre.

KONCEPTI, QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit

Plani i integritetit është një dokument i brendshëm trevjeçar dhe përditësohet çdo vit.

Plani i integritetit është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë së integritetit brenda institucionit dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të institucionit.

Si i tillë, plani shërben për identifikimin e rreziqeve, analizave dhe vlerësimin e rrezikut dhe specifikon masat për arritjen e objektivave të integritetit, për të avancuar performancën e integritetit në sektorin e administratës publike dhe fuqizimin e sundimit të ligjit dhe vlerave e standardeve profesionale.

Plani i integritetit duhet shqyrtuar në mënyrë periodike dhe të aktualizohet në pajtueshmëri me zhvillimet relevante normative, institucionale dhe procedurale.

Plani rithekson përkushtimin e MINT, për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të Ministrisë.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të institucionit dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

QËLLIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT

Përditësimi i Planit të Integritetit ka për qëllim përmirësimin e veprimeve dhe masave të ndërmarra nga MINT për të rritur besimin publik ndaj saj, si edhe për përmirësimin e mekanizmave kundër korrupsionit dhe rritjen e transparencës së institucionit.

Për arritjen e qëllimit janë identifikuar këto objektiva:

- Zbatimi i normave ligjore dhe standardeve të etikës në të gjitha nivelet e Ministrisë;
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
- Rritja e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes aktive qytetare;
- Menaxhimi i buxhetit dhe kontrollit financiar;
- Llogaridhënia publike dhe transparenca për sigurimin e besueshmërisë së institucionit

OBJEKTIVAT:

Zbatimi i normave ligjore dhe standardeve të etikës në të gjitha nivelet e Ministrisë

Për të përmirësuar dhe forcuar mekanizmat e etikës dhe integritetit, Ministria do të punojë në:

- Zbatimin e akteve ligjore të lidhura me etikën;
- Zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, bazuar në parimet e etikës dhe integritetit;
- Respektimi rigoroz i normave etike nga punonjësit e administratës së Ministrisë, është i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi pune, që parandalon sjelljen jo-etike dhe joprofesionale.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Ministria bazuar në Ligjin për Zyrtarët Publikë, si dhe aktet nënligjore garantojnë krijimin e një shërbimi civil profesional dhe të qëndrueshëm.

Ministria angazhohet në vazhdimësi për menaxhimin e burimeve njerëzore, e cila do të bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mos diskriminimit, meritave, transparencës, profesionalizmit, integritetit, mos reflektimit politik gjatë shërbimit, që garantojnë stabilitetin e nëpunësve në shërbimin civil.

Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare

Ministria do të punojë për zbatimin e mekanizmave të transparencës dhe pjesëmarrjes qytetare, që do të rrisë besimin e publikut ndaj Ministrisë dhe do të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore publike.

Duke pasur parasysh rëndësinë e qasjes në informacionin publik për krijimin e një administrate transparente, Ministria do të vijojë të punojë në drejtim të metodave pro-aktive në publikimin e informacionit publik për aktivitetet e planifikuara dhe të përfunduara të Ministrisë.

Pjesëmarrja qytetare do të jetë në fokus të Ministrisë nëpërmjet bashkëpunimit me ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, organizata ndërkombëtare dhe shoqatat e biznesit, për të përmirësuar pjesëmarrjen e tyre në fusha të ndryshme.

Ministria vazhdon të zbatojë mekanizmat e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe grupeve të veçanta të interesit gjatë zhvillimit dhe konsultimit të dokumenteve, politikave, strategjive, apo ligjeve në fushën e saj të përgjegjësisë.

Menaxhimi i buxhetit dhe kontrollit financiar

Menaxhimi i buxhetit dhe kontrollit financiar janë bazë për vlerësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të kontrollit financiar.

Për arritjen e objektivave të menaxhimit të buxhetit dhe kontrollit financiar kërkohet angazhim në të gjitha nivelet në kuadër të Ministrisë.

Efektiviteti në menaxhimin e buxhetit dhe të kontrollit financiar do të ndikojë në rritjen e performancës së institucionit në fushën financiare, duke u bazuar në legjislacionin përkatës në fuqi.

Prokurimi Publik

Objektivi i Prokurimit Publik është të sigurojë zbatueshmërinë e Ligjit për Prokurim Publik, mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike.

Ministria vazhdon të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publikë, që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke i zbatuar aktet ligjore për procedurat e prokurimit: të mos

ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës

METODOLOGJIA E PLANIT TË INTEGRITETIT

Plani i Integritetit të MINT për periudhën 2024-2026 përmban objektivat, të cilat do të arrihen në bazë të një plani të veprimit, i cili është pjesë përbërëse e planit, lidhur me vetëvlerësimin për ekspozimin e MINT ndaj korrupsionit dhe formave tjera të shkeljes së integritetit, duke i marrë për bazë masat ekzistuese të kontrollit, masat parandaluese për zvogëlimin e riskut të korrupsionit dhe formave tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për aplikimin e tyre, që janë pjesë përbërëse e Planit të Integritetit të MINT.

Plani i Veprimit përfshin tërësinë e masave për të adresuar risqet dhe faktorët e risqeve të integritetit, të identifikuara sipas fushave të përgjegjësisë së Ministrisë. Plani përmban përshkrime për aktivitetet specifike që do të zbatohen për të arritur objektivat e Planit të Integritetit.

Zbatimi i Planit të Integritetit do të pasohet nga procesi i raportimit dhe monitorimit. Raportimi është një procedurë e rregullt, që siguron zbatimin e Planit të Integritetit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces mbikëqyret nga personi përgjegjës, i caktuar nga institucioni dhe nga AKK, të cilët janë përgjegjës për të ndjekur progresin e zbatimit.

Monitorimi do të përcaktojë nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efektive dhe nëse kanë nxjerrë në pah ndryshime të kontekstit të institucionit apo ndryshime të vetë risqeve. Pas monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit, Ministria do ta rishikojë dokumentin dhe do ta përditësojë atë me sfidat e ardhshme. Ministria do të publikojë raportin e monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit për periudhën 2024-2026.

Procesi i zhvillimit të përditësimit të Planit të Integritetit

Përditësimi i Planit të Integritetit është bërë sipas fazave në vijim:

- **Faza e parë:** U.d Sekretar i Përgjithshëm në MINT ka nxjerrë Vendim nr.5416/02, të datës 02.12.2025 për formimin e Grupit Punues dhe caktimin e zyrtares përgjegjëse për monitorimin e tërë procesit për përditësimin e Planit të Integritetit 2024-2026 të MINT. Ky grup punues përbëhet nga dhjetë (10) anëtarë. Grupi punues ka analizuar Planin e Integritetit 2024-2026 të MINT, duke vlerësuar fushat që mund të kenë ndikim në cenimin e integritetit në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këto analiza dhe vlerësime për përditësimin të Planit të Integritetit 2024-2026, grupi punues ka mbajtur takime si në vijim:

- Takimi i parë është mbajtur me datën 05.12.2025, grupi punues ka shqyrtuar informatat bazë të Planit të Integritetit, si dhe metodologjinë për realizimin e përditësimit të këtij plani. Po ashtu është analizuar edhe forma e përditësimit të matricës së aktiviteteve në kuadër të planit;
 - Takimi i dytë është mbajtur me datën 11.12.2025, ku Grupi Punues ka bërë analizimin e aktiviteteve të përfshira në plan, si dhe realizimi i tyre gjatë vitit 2025;
 - Takimi i tretë është mbajtur me datën 17.12.2025 është diskutuar rreth përfshirjes së informatave shtesë nga departamentet e MINT. Grupi Punues ka kërkuar edhe njëherë përmes emailit (outllok) nga të gjitha njësitë e MINT, të na dërgojnë informata shtesë se a kanë pasur plotësim/ndryshim të risqeve të parapara në kuadër të Planit, si dhe mundësia e përfshirjes së informatave shtesë, që nuk kanë qenë të përfshira në planin e Integritetit 2024-2026, e që tashmë janë të domosdoshme të përfshihen.
- **Faza e dytë:** Punëtorja e organizuar nga Grupi Punues, me datën 19-21.12.2025, është realizuar, ku janë analizuar objektivat e parapara dhe të propozuara që duhet të përfshihen në përditësimin e PPI-së, ku është bërë:
 - Analiza e të gjitha informatave dhe identifikimi i fushave që duhet të përfshihen në përditësimin e Planit të Integriteti;
 - Inkorporimi i informatave/fushave të departamenteve të MINT, të cilat mund ta cenojnë integritetin e MINT;
 - **Faza e tretë:** Personi përgjegjës për monitorim dhe raportim ka rishikuar raportet mbi ecurinë e zbatimit të masave, duke u bazuar në matricën standarde të monitorimit dhe raportimit. Gjatë

këtij procesi janë analizuar fushat e rrezikut dhe është vlerësuar ndikimi i masave në uljen e nivelit të rrezikut.

Drafti i planit të përditësuar dërgohet për komente në njësitë përkatëse, për harmonizim dhe përmbajtje të unifikuar.

Drafti i përditësuar është përcjellë në Agjenci për komentim dhe për verifikim të përputhshmërisë me udhëzuesin përkatës.

Plani miratohet me vendim zyrtar nga udhëheqësi më i lartë administrativ.

FUSHAT E RREZIKUT

FUSHAT E PËRGJITHSHME TË RREZIKUT:

- Rreziku në planifikimin dhe menaxhimin financiar;
- Rreziku në menaxhimin dhe administrimin e procedurave të burimeve njerëzore;
- Rreziku në cenimin e integritetit të Ministrisë në mungesë të transparencës dhe llogaridhënies;
- Rreziku i cenimit të integritetit të Ministrisë në mungesë të menaxhimit dhe raportimit të realizimit të kontratave të prokurimit publik.

METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RREZIKUT

Vlerësimi i riskut do të thotë renditja e risqeve më të larta në krye të listës, që paraqesin efekte thelbësore në integritetin e Ministrisë dhe potencialisht mund të rrezikojnë efikasitetin, besueshmërinë dhe imazhin e jashtëm të Ministrisë.

Kjo duhet të jetë baza për përcaktimin e masave për trajtimin e rrezikut. Prandaj prioritetet përcaktohen ashtu si, resurset e kufizuara në dispozicion për trajtim, mund të vendosen aty ku vërehet se janë më të nevojshme. Në përgjithësi, rreziqet e kategorizuara si të vogla, në përputhje me standardet për marrje të rrezikut dhe nuk imponojnë nevojën për masa shtesë të trajtimit, por kërkojnë monitorim të efikasitetit të masave ekzistuese të trajtimit/kontrollit.

Rreziqet e larta kërkojnë trajtim të vazhdueshëm duke ndërmarrë masa adekuate.

Metoda e vlerësimit të rrezikut

Metoda e Vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose jo-etike.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e pasojës, qw mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /Ndikimi	Madhor													
		Mesatar												
			Vogël											
	Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar			Lart					
			Probabiliteti/Gjasat											

Intensiteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lart.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
U	M	L

- Rreziku me intensitet të ulët – mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.
- Rreziku me intensitet të mesëm – ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.
- Rreziku me intensitet të lartë – korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Zyrtari përgjegjës brenda institucionit dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Monitorimi i planit të integritetit po ashtu do të sigurojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rrezikut të mundshëm kanë mundur arritjen e qëllimeve të planifikuara në trajtimin e rreziqeve të mundshme dhe se të njëjtat kanë identifikuar veprime për ndërmarrjen e masave të reja në të ardhmen.

Zyrtari përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit, në bashkëpunim dhe koordinim me grupin punues, menxhmentin dhe gjithë zyrtarët e ministrisë do të sigurojë raporte të rregullta periodike për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit rreth zbatimit të planit të integritetit.

NR.	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i RREZIKUT	Masat ekzistuese të kontrollit	Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Departamenti / Njësia/personi përgjegjës	Afati i realizimit
				Ndikimi	Gjasat	Vlerësimi i rrezikut			
1	Zbatimi i normave ligjore dhe standardeve të etikës në të gjitha nivelet e Ministrisë	Mos respektimi i kodit të etikës. Mos identifikimi i rasteve të shkeljeve etike dhe mos ndërmarrja e masave për parandalimin e tyre.	Zbatimi i kodit të etikës nga udhëheqësit e njësive në bashkëpunim me Njësinë e Burimeve Njerëzore.	U	U	U	Organizimi i trajnimeve për zyrtarët e MINT mbi praktikatat dhe parimet e etikës. Promovimi i vazhdueshëm i vlerave të etikës profesionale të të gjithë punonjësve të institucionit.	Njësia e Burimeve Njerëzore	Janar- dhjetor
2	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore	Mungesa e identifikimit të nevojave për përmbushjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në Ministri.	Zhvillimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore, bazuar në normat ligjore.	M	M	M	Identifikimi i nevojave për plotësimin e vendeve të punës me zyrtarë brenda MINT.	Njësia e Burimeve Njerëzore	Janar- dhjetor
3.	Rritja e transparences, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes aktive qytetare	Mos publikimi i informatave, dokumenteve dhe aktiviteteve në kohë reale do të ndikojë negativisht në imazhin e Ministrisë;	Publikimi i dokumenteve zyrtare dhe politikave të Ministrisë në	M	M	M	Publikimi i informatave zyrtare, dokumenteve dhe aktiviteteve të përgjithshme të Ministrisë në platforma digjitale (Web-faqe,	Divizioni për Komunikim me Publikun	Janar-dhjetor

	shpenzimeve me kohë për avancet e hapura.	menaxhmentit të lartë përmes emailave zyrtare për obligimet e avanceve të hapura.				iu adresohen udhëheqësve të linjave buxhetore. Marrja e masave me vendim për ndalesë në pagë, bazuar në Rregulloren nr.06/2023 për kompenzim të udhëtimeve zyrtare dhe shpenzimeve të përfaqësimit.		
	Mos përgatitja e Raportit vjetor financiar sipas instruksioneve të pranuar nga Thesari i Kosovës/MFPT.	Mos pranimi me kohë i informatave nga njesitë, që targetohen në këtë raport, të bazuar sipas Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.	U	U	M	Të bëhet ngritja e vetëdijes nga secila njësi për përgjesishtë, që dalin nga kjo kërkesë, si dhe të përgjigjen në kohë për kërkesën e adresuar.		
	Mungesa e adresimit me kohë të specifikimeve teknike konform afateve ligjore.	Përgatitja e planit të prokurimit në përputhje me planifikimet buxhetore dhe realizimi i Planit të Prokurimit sipas LPP,	M	M	M	Evitimi i mangësive duke realizuar takime të rregullta individuale me njesitë kërkuese për realizim të Planit të Prokurimit dhe të zbatueshëm sipas LPP-së.		
5. Prokurimit Publik	Mos zbatimi i kontratave me kohë nga OE rritë rrezikun që planet e ardhshme të shpenzimeve të mos arrihen për shkak të nevojës për t'i paguar shpenzimet, që dalin si rezultat i vitit paraprak.	Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe raportojnë, si dhe të sigurojnë se OE-të realizojnë	M	M	M	Kontrulli dhe zbatimi i LPP-së të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar, të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme		Divizioni i Prokurimit Janar-dhjetor

		institucionit			paautorizuar dhe duke forcuar transparencën e procesit.	
7	<p>Regjistrimi i udhërrëfyesve turistikë</p>	<p>Ushtrimi i veprimtarisë pa regjistrim të udhërrëfyesve turistikë përveç se paraqet shkelje ligjore, mund të paraqet edhe një perceptim pa siguri për grupet e turistëve që vizitojnë Kosovën dhe mund të ndikon negativisht në imazhin e shtetit.</p> <p>Mungesa e udhërrëfyesve vendor të regjistruar gjithashtu mund të mundëson hyrjen e udhërrëfyesve të huaj dhe dezinformonim e turistëve të jashtëm lidhur me historinë dhe trashëgiminë tonë kulturore.</p>	<p>Zbatueshmëria e legjislacionit në fuqi siguron që veprimtaritë të zhvillohen vetëm në përputhje me dispozitat ligjore, duke parandaluar shkeljet dhe duke forcuar integritetin institucional.</p> <p>Inspektimet nga inspektoratet kompetente mundësojnë verifikimin e respektimit të kriterëve ligjore dhe parandalimin e ushtrimit të veprimtarive pa leje.</p>	<p>M</p> <p>M</p> <p>M</p>	<p>Organizimi i takimeve informuese me akterët relevantë të turizmit siguron komunikim të drejtpërdrejtë dhe informim mbi detyrimet ligjore e procedurat e licencimit, duke reduktuar rrezikun e ushtrimit të veprimtarive pa leje dhe duke forcuar transparencën në sektorin e turizmit.</p> <p>Ngritja e kapaciteteve të inspektoratit për mbikëqyrjen e veprimtarive turistike dhe zbatueshmerin e legjislacionit për turizmin.</p>	<p>Departamenti i Turizmit</p> <p>Qershor-dhjetor</p>

	<p>Mungesa e stafit</p>	<p>M</p>	<p>M</p>	<p>M</p>	<p>Adresimi i çështjes dhe identifikimi i mundësisë së rekrutimit të stafit.</p>	<p>Departamenti i Industrisë</p>	<p>Janar-dhjetor</p>
<p>8</p> <p>Zhvillimi i Infrastrukturës së Cilësisë</p>	<p>Moszbatimi i rregulloreve për sigurinë e ashensorëve dhe mosmirëmbajtja e platformës së regjistrimit paraqet rrezik për sigurinë publike, transparencën dhe besueshmërinë e institucionit.</p>	<p>M</p>	<p>M</p>	<p>M</p>	<p>Mungesa e stafit paraqet pengesa në realizimin e plotë të këtij aktiviteti.</p> <p>Moskoordinimi i inspektorateve të MMPHI dhe atyre komunale e pengon zbatimin në plotëni të këtij aktiviteti.</p>	<p>Organizimi i takimeve me institucionet relevante dhe kompanitë mirëmbajtëse të ashensorëve për zbatimin e masës siguron koordinim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm, rrit transparencën dhe parandalon vonesat apo mangësitë në mirëmbajtjen dhe regjistrimin e ashensorëve.</p>	<p>Departamenti i Industrisë</p> <p>Janar-dhjetor</p>
<p>9</p> <p>Licencimi i subjekteve që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij</p>	<p>Mos respektimi i afateve ligjore për trajtimin e kërkesave mund të çojë në nënligjore për vonesa të panevojshme, ngarkesë shtesë administrative dhe perceptim të mungesës së efikasitetit, duke rrezikuar besueshmërinë dhe funksionimin efektiv të institucionit si dhe shikaktim të dëmit financiar per Ministrinë.</p>	<p>M</p>	<p>M</p>	<p>M</p>	<p>Zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore për dhënie e lejeve për duhan siguron që procesi i dhënies së lejeve të bëhet vetëm sipas kritereve dhe afateve të përcaktuara me ligj, si dhe eviton çdo ankesë të mundshme per</p>	<p>Krijimi i një regjistri për evidentimin e aplikimeve dhe shënjimin e afateve parandalon vonesat dhe mosrespektimin e afateve ligjore, sepse çdo kërkesë evidentohet dhe ndiqet sipas kohës, siguron transparencë të procesit, duke shmangur humbjen ose neglizhimin e aplikimeve.</p>	<p>Departamenti i Tregtisë</p> <p>Janar-dhjetor</p>

	negativisht në respektimin e afateve ligjore, të krijuar nga ngarkesë shtesë administrative dhe të rrezikojë humbjen e mbështetjes financiare nga donatorët, duke ulur kapacitetin e institucionit për të menaxhuar në mënyrë efektive tregtinë me mallra strategjike	respektimin e procedurave ligjore			menaxhimin efikas të aplikimeve dhe rrit transparencën e procesit	
--	---	-----------------------------------	--	--	---	--

Përditësimet dhe ndryshimet e bëra në Planin e Integritetit

Si rezultat i analizës së proceseve të brendshme institucionale, vlerësimit të zbatimit të masave ekzistuese, si dhe forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, Plani i Integritetit është përditësuar me qëllim të reflektimit më të saktë të rreziqeve aktuale dhe sfidave operative.

Gjatë këtij procesi janë identifikuar rrethana të reja që mund të ndikojnë në integritetin, efektivitetin dhe cilësinë e vendimmarrjes institucionale. Për këtë arsye, në Planin e Integritetit janë përfshirë rreziqe të reja, të cilat nuk ishin të evidentuara në versionet e mëhershme, por që paraqesin potencial për cenim të integritetit institucional nëse nuk adresohen në mënyrë sistematike.

Përfshirja e këtyre rreziqeve synon forcimin e mekanizmave parandalues, rritjen e transparencës, si dhe përmirësimin e monitorimit dhe llogaridhënies në proceset institucionale.

Identifikimi dhe përfshirja e rreziqeve të reja

Departamenti për Rregullimin e Tregut të Naftës

Fusha e përgjithshme e rrezikut –Licencimi i subjekteve ekonomike për tregti me naftë dhe derivate të saj është një proces me rëndësi të veçantë për integritetin institucional.*Përfshirja e rrezikut është subjektet që operojnë pa leje cenonjë sigurinë e tregut dhe besueshmërinë e administratës, duke krijuar rrezik për shmangie të detyrimeve fiskale, mosrespektim të standardeve teknike e mjedisore dhe konkurrencë të padrejtë. Kjo situatë ndikon negativisht në transparencën dhe efikasitetin e institucionit.*

Për menaxhimin e këtij rreziku, *masat kontrolluese* përfshijnë inspektimin e rregullt nga Inspektorati i Tregut, si dhe mirëmbajtjen e databazës së lejeve të fësnuara, e cila siguron evidencë të saktë dhe të përditësuar të subjekteve të licencuara.

Si masë parandaluese, është bashkërendimi dhe shtimi i aktiviteteve me Inspektoratin e Tregut (MINT), që synon zvogëlimin e numrit të subjekteve që operojnë pa leje, ndërsa zbatimi i afateve ligjore dhe kriterëve të përcaktuara garanton që kërkesat të trajtohen vetëm sipas procedurave ligjore, duke forcuar transparencën dhe llogaridhënien e institucionit.

Departamenti i Turizmit

Fusha e përgjithshme e rrezikut- Regjistrimi i udhërrëfyesve turistikë përbën një fushë të rëndësishme të rrezikut, pasi mosfunksionimi i këtij procesi mund të sjellë pasoja ligjore, institucionale dhe imazhit të shtetit.

Përshkrimi i rrezikut është ushtrimi i veprimtarisë pa regjistrim të udhërrëfyesve turistikë jo vetëm që përbën shkelje ligjore, por krijon edhe perceptim pasigurie për grupet e turistëve që vizitojnë Kosovën. Kjo situatë mund të ndikojë negativisht në imazhin e shtetit dhe të cenojë besueshmërinë e institucioneve përgjegjëse. Mungesa e udhërrëfyesve vendor të regjistruar hap mundësi për hyrjen e udhërrëfyesve të huaj, të cilët mund të ofrojnë informata të pasakta apo të shtrëmbënuara mbi historinë dhe trashëgiminë kulturore të vendit, duke rrezikuar kështu prezantimin e saktë të identitetit kulturor dhe historik të Kosovës. *Si masë kontrolluese* është zbatueshmëria e legjislacionit në fuqi siguron që të gjitha veprimtaritë të zhvillohen vetëm në përputhje me dispozitat ligjore, duke parandaluar shkeljet dhe duke forcuar integritetin institucional. Përveç kësaj, inspektimet e rregullta të kryera nga inspektoratet kompetente mundësojnë verifikimin e respektimit të kriterëve ligjore dhe parandalojnë ushtrimin e veprimtarive pa leje. *Si masë parandaluese* është organizimi i takimeve informuese me akterët relevantë të turizmit siguron komunikim të drejtpërdrejtë dhe ofron informim të qartë mbi detyrimet ligjore dhe procedurat e licencimit. Kjo praktikë redukton rrezikun e ushtrimit të veprimtarive pa leje dhe forcon transparencën në sektorin e turizmit. Ngritja e kapaciteteve të inspektoratit për mbikëqyrjen e veprimtarive turistike dhe për zbatueshmërinë e legjislacionit kontribuon në rritjen e efikasitetit të kontrollit, duke siguruar respektimin e standardeve ligjore dhe mbrojtjen e integritetit institucional.

Departamenti i Industrisë

Fusha e përgjithshme e rrezikut- Zhvillimi i Infrastrukturës së Cilësisë përbën një fushë të rëndësishme të rrezikut, pasi vonesat ose mangësitë në këtë proces mund të ndikojnë drejtpërdrejt në besueshmërinë e produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga institucionet. *Përshkrimi i rrezikut* është moszbatimi i rregulloreve për sigurinë e ashensorëve dhe mosmirëmbajtja e platformës së regjistrimit paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për sigurinë publike, transparencën dhe besueshmërinë e institucionit. *Masa kontrolluese* lidhet me mungesën e stafit, e cila krijon pengesa në realizimin e plotë të aktivitetit, si dhe me moskoordinimin ndërmjet inspektorateve të MIMPHI dhe atyre komunale, që e pengon zbatimin e tij në tërësi. Për të adresuar këto sfida, *si masa parandaluese* mirëmbajtëse të ashensorëve. Këto masa sigurojnë koordinim dhe bashkëpunim të vazhdueshëm, rrisin transparencën dhe parandalojnë vonesat apo mangësitë në mirëmbajtjen dhe regjistrimin e ashensorëve.

Departamenti i Tregtisë

Fusha e përgjithshme e rrezikut- Licencimi i subjekteve që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij përbën një fushë të rrezikut nëse procesi i licencimit nuk zbatohet me transparencë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, mund të krijohen perceptime për favorizime apo keqpërdorime, duke ndikuar negativisht në imazhin e shtetit dhe në besimin e qytetarëve. **Përshkrimi i rrezikut** është procesi i licencimit të subjekteve që merren me tregtimin e duhanit dhe produkteve të tij paraqet një fushë me rëndësi të veçantë për integritetin institucional. Mosrespektimi i afateve ligjore për trajtimin e kërkesave mund të sjellë vonesa të panevojshme, ngarkesë shtesë administrative dhe perceptim të mungesës së efikasitetit, duke rrezikuar besueshmërinë dhe funksionimin efektiv të institucionit si dhe mund të demtojë institucionin materialisht nga padite e paleve për shkaktim në vonesa dhe kosto shtese. Për të menaxhuar këtë rrezik si **Masa kontrolluese** është zbatimi i akteve ligjore dhe nënligjore për dhënie dhe lejeve për duhan ku siguron që procesi të zhvillohet vetëm sipas kritereve të përcaktuara me ligj. Njoftimi i palëve përmes takimeve fizike ose telefonit duke mundësuar sqarime të menjëhershme.

Si masë parandaluese është krijimi i një regjistri për evidentimin e aplikimeve dhe shënimit e afateve. Përmes tij, procesi bëhet më transparent, shmangen humbjet ose neglizhimet e aplikimeve dhe reduktohet rreziku i pakënaqësisë së qytetarëve, duke mbrojtur integritetin e institucionit.

Gjithashtu, mungesa e informimit të plotë të palëve gjatë aplikimit për leje mund të shkaktojë keqkuptime, vonesa dhe pakënaqësi, duke rrezikuar transparencën dhe besueshmërinë e institucionit. Një masë parandaluese shtesë është vetëdijesimi i palëve lidhur me platformën zyrtare për leje dhe licenca. Kjo siguron që aplikimet të bëhen në mënyrë të plotë dhe të saktë, redukton vonesat dhe refuzimet, si dhe forcon transparencën dhe besueshmërinë e institucionit, duke rritur efikasitetin e procesit administrativ.

Departamenti Kontrollit të tregtisë me mallra strategjike

Fusha e përgjithshme e rrezikut- Mungesa e digitalizimit të procedurave licencuese rreth kontrollit të tregtisë me mallra strategjike mungesa e digitalizimit të procedurave licencuese për kontrollin e tregtisë me mallra strategjike paraqet një rrezik të konsiderueshëm për transparencën, efikasitetin dhe sigurinë institucionale. **Përshkrimi i rrezikut** është vonesa në digitalizimin e procedurave licencuese ku ndikon negativisht në respektimin e afateve, dhe të rrezikojë humbjen e mbështetjes financiare nga donatorët, duke ulur kapacitetin e institucionit për të menaxhuar në mënyrë efektive tregtinë me mallra strategjike. Për të menaxhuar këtë rrezik, **si masë kontrolluese** është licencimi në mënyrë fizike, ku procesi kryhet drejtpërdrejt nga zyrtarët përgjegjës. Kjo siguron verifikimin e dokumenteve dhe respektimin e procedurave ligjore, duke garantuar që lejet të jepen vetëm sipas kritereve të përcaktuara. **Masë parandaluese** është përkrahja dhe mbështeta financiare për finalizimin e digitalizimit siguron funksionimin e bazës së të dhënave sipas standardeve dhe forcon kapacitetin e institucionit për menaxhimin efikas të aplikimeve dhe rrit transparencën e procesit

Arsyetimi për Heqjen e rrezikut nga Matrica standarde

Përshkrimi i rrezikut -Mos-transparenca e zhvillimit të procedurave të rekrutimit, ky rrezik është i lidhur me procesin e zhvillimit të procedurave të rekrutimit. Sipas ligjislacionit në fuqi dhe kompetencave të institucionit, ky aktivitet nuk bën pjesë në detyrat dhe përgjegjësitë të institucioni, përkatësisht nuk është aktivitet që realizohet nga Njësia e NBNJ-së. Për pasojë, rreziku nuk është relevant për monitorim dhe nuk përfshihet në Planin i Integritetit.

Përfundim: Rreziku është i pavlefshëm për institucionin dhe largimi i tij nga Planin i Integritetit është i justifikuar.